



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:258524
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05065541

C-IV.-14-6424

Ankuesi:

V Z M nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Gërmia”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.06 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN093-0796 i dt.21 gusht 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.03 tetor 2014, ankuesja ish punëtore e NSH “Gërmia” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN093-0796 i dt.21 gusht 2014, me të cilin ka kërkuar kompensim për asistencë sociale. Ankesën e paraqet për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja në ankesë ka deklaruar se vendimi i atakuar është konfuz dhe diskutabil. AL i ka pasur listën e pagave dhe ankuesi theksoi se si kreditor ka interes të ligjshëm për kompensim të mjeteve të asistencës Ankesës i ka bashkangjitur: Formularin e kërkesës për likuidim, Vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr.749 dt.18.06.2001.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.03 tetor 2023 ka lëshuar një urdhër për ankuesen, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e kopjes së vendimit të atakuar, kopjes së njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës së pagave dhe prova të tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Ankuesja e ka pranuar këtë urdhër dhe me dt.18 tetor 2023 i është përgjigjur të njëjtit duke sjellë Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Njoftimin e AKP nr.8429 st.24.07.2014, Vendimi nr.650 dt.30.01.2009, Kopja e librezës së punës, Formularin e kërkesës për likuidim.

Me dt.16 nëntor 2023 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Ankuesja nuk tregoj se cilin nen e ka shkelur AL me rastin e marrjes së vendimit, prandaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht ankesa është e pa bazuar dhe e parashkruar konform dispozitave ligjore. Ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për asistencë sociale. Ankuesja ka dorëzuar

kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës (pa emër dhe nënshkrim), Kërkesa Njoftimin e AKP nr.8429 të dt .24.07.2014, Vendimin nr.650 dt.15.01. 2003, Kopjen e librezës së punës e mbyllur me dt. 30.06.1998 dhe Formularin e kërkesës për likuidim e dt. 11.tetor 2007 . Ankuesja ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas parashtrimit të urdhrin të dt.03 tetor 2023, duke sjellë prova të cilat nuk dëshmojnë se ankueses i takojnë kompensimi për asistencë sociale.

Provat të cilat ankuesja i ka dorëzuar së bashku me ankesë dhe përmes parashtrësës, nuk dëshmojnë se ankueses NSH-ja i ka mbetur borxh. Vendimi nr.749 dt.18.06.2001, dëshmon se ankuesja përkohësisht është e pa angazhuar në punë dhe detyra të punës dhe gëzon të drejtën e asistencës sociale, kurse vendimi nr.650 dt.15.01.2003 dëshmon se ankuesja është e vendosur në asistencë sociale nga dt.01.01.2003 deri me dt.31.03.2003. Kurse, për periudhën kohore 01.01.2005 deri më 14. 08.2007 për të cilën ankuesja ka theksuar se NSH-ja i ka mbetur borxh shumë prej 1,575.00 € nuk e argumentoi me asnjë provë apo vendim i cili do ta obligonte NSH-në –AKP-në për t’ia kompenzuar borxhin.

Nga kjo gjykatë vjen në përfundim që parashtruesja e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesja do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa vite ka punuar tek e paditura, se sa e ka pasur lartësinë e pagës mujore dhe listën e pagave të cilat ankuesja pretendon se ndërmarrja i ka mbetur borxh për shkak të asistencës sociale. Por e njëjta e ka pranuar urdhrin e lëshuar nga gjykata me dt.03 tetor 2023 dhe përkundër se i është përgjigjur të njëjtit, nuk i ka sjell dokumentet e nevojshme me të cilat do të bënte të besueshme kërkesën e saj. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për shkak të asistencës sociale, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t’i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesja e ka paguar taksën me dt.19 shtator 2023.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala